



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2024:023339
Datë: 25.03.2024
Numri i dokumentit: 05497439

Pml.nr.188/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Rasim Rasimi, kryetar i kolegjit, Afrim Shala dhe Agim Maliqi, anëtarë të kolegjit, me bashkëpunëtoren profesionale Qefsere Berisha, në çështjen penale ndaj të pandehurit L. M., për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprat penale: rrëmbimi nga neni 191 par.2 nën par. 2.3 lidhur me par. 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par. 2 lidhur me par. 1 dhe lidhur me nenin 31 të KPRK dhe mbajtja në pronësi, kontroll, ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK, duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të të pandehurit av. Valdet Hoxha, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, PPRKR.nr.15/2024 të datës 16.2.2024 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PNI.DKR.nr.177/2024 të datës 27.2.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 25.3.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësit të të pandehurit L. M., e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Krimeve të Rënda, PPRKR.nr.15/2024 të datës 16.2.2024 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PNI.DKR.nr.177/2024 të datës 27.2.2024.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti i Krimeve të Rënda, me aktvendimin PPRKR.nr.15/2024 të datës 16.2.2024, të pandehurve F. K., G. K. dhe L. M., për shkak të dyshimit të bazuar se kanë kryer veprat penale: rrëmbimi nga neni 191 par.2 nën par. 2.3 lidhur me par. 1 të KPRK, lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par. 2 lidhur me par. 1 dhe lidhur me nenin 31 të KPRK dhe secili veç e veç veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll, ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK, ua ka vazhduar masën e paraburgimit në kohëzgjatje prej 2 (dy) muajve, e cila masë do t'iu zgjasë nga data 19.2.2024 deri më datën 18.4.2024. Masa e paraburgimit iu është vazhduar në bazë të nenit 188 lidhur me nenin 184 par. 1 nën par. 1.1 dhe 1.2 pika 1.2.1, 1.2.2 dhe 1.2.3 të Kodit të Procedurës Penale (KPP).

Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktvendimin PNI.DKR.nr.177/2024 e datës 27.2.2024, i ka refuzuar si të pabazuara ankesat e mbrojtësve të të pandehurve dhe e ka vërtetuar aktvendimin e shkallës së parë.

Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar mbrojtësi i të pandehurit L. M. av. Valdet Hoxha, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal dhe shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale ku shkeljet e tilla kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, me propozim që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë të aprovohet si e bazuar dhe të ndryshohen aktvendimet e kundërshtuara dhe të pandehurit t'i ndërprehet masa e paraburgimit.

Kryeprokurori i Shtetit, me shkresën KMLP.III.nr.78/2024 të datës 21.3.2024, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të pandehurit të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par. 1 lidhur me nenin 436 par. 1 të KPP, vlerësoi pretendimet në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë dhe gjeti se:

- kërkesa është e pabazuar.

Në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, mbrojtësi i të pandehurit thekson se nuk qëndrojnë pretendimet e gjykatës dhe nuk janë përmbushur kushtet ligjore për vazhdimin e paraburgimit, sepse i pandehuri ka interes që të zbardhet e vërteta dhe se do të vërtetohet se i njëjti nuk ka fare të bëjë me veprën penale që i vihet në barrë. Ai është shtetas i Republikës së Kosovës, është e njohur adresa e tij, është familjarë dhe nuk ka interes të largohet nga vendi dhe familja e tij. I pandehuri është dorëzuar vullnetarisht pranë policisë, ka qenë bashkëpunues dhe i sinqertë duke iu ndihmuar organeve kompetente për t'i vërtetuar të gjitha faktet dhe veprimet e tij e të cilat veprime nuk bien ndesh me ligjin sepse ai nuk ka të bëjë fare me veprën penale që i vihet në barrë. Prokuroria është dashur që të specifikojë se kush çfarë veprimi ka ndërmarrë konkretisht por vetëm ka bërë përshkrim sipërfaqësor të rastit. Nuk ka rrezik të asgjësimit dhe fshehjes apo ndryshimit të provave të veprës penale.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet e mësipërme janë të pabazuara, ngase nga provat që gjenden në shkresat e lëndës, nga kallëzimi penal me numër të rastit 2024-

AD-092 të datës 20.1.2024, aktvendimit për fillimin e hetimeve, procesverbalet e marrjes në pyetje të të dëmtuarit dhe dëshmitarit, deklaratat e të pandehurve ku të pandehurit pjesërisht i kanë pranuar veprimet e tyre si dhe shkresave tjera në lëndë, rezulton dyshimi i bazuar se i pandehuri dyshohet se ka kryer veprat penale për të cilat pandehet, kurse a do të argumentohen këto fakte e prova do të vlerësohet në fazat e ardhme të procedurës penale, me çka janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 184 par. 1 nën par. 1.1. e 1.2. të KPP.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, ka bazë ligjore për vazhdimin e paraburgimit konform nenit 184 par. 1 nën par. 1.1 e 1.2 pika 1.2.1 të KPP, ngase me lëshimin e të pandehurit në liri ekziston rreziku i fshehjes apo arratisjes me qëllim të shmangies nga përgjegjësia penale e në këtë mënyrë do ta pamundësojnë zhvillimin e rregullt të procedurës penale.

Kjo gjykatë vlerëson se ka bazë ligjore për vazhdimin e paraburgimit konform nenit 184 par. 1 nën par. 1.1 e 1.2 pika 1.2.2 të KPP, ngase me lëshimin e të pandehurit në liri ekziston rreziku i ndikimit në të dëmtuarin, dëshmitarët apo te bashkë të pandehurit te njëri tjetri që t'i koordinojnë deklaratat me qëllim të shmangies nga përgjegjësia penale, e në këtë mënyrë do ta pamundësojnë zhvillimin e rregullt të procedurës penale.

Po ashtu, kjo Gjykatë vlerëson se ka bazë ligjore për vazhdimin e masës së paraburgimit konform nenit 184 par. 1 nën par. 1.2 pika 1.2.3 të KPP, duke pasur parasysh peshën e veprës penale, mënyrën dhe rrethanat në të cilat dyshohet se është kryer vepra penale, janë rrethana të cilat tregojnë se po të gjendet i pandehuri në liri ekziston rreziku se do të mund të përsëris veprat penale të natyrës së njëjtë apo të ngjashme, andaj vazhdimi i paraburgimit është i arsyeshëm për rrjedhën normale të procedurës penale.

Sa i përket pretendimeve të mbrojtësit se është dashur që të specifikohet se kush çfarë veprimi ka ndërmarrë konkretisht, por vetëm është bërë përshkrim sipërfaqësor i rastit, kjo Gjykatë gjen se rasti është në fazën e hetimeve dhe pritët që në fazat e ardhme të qartësohet dhe specifikohen të gjitha faktet dhe rrethanat që kanë të bëjnë me rastin.

Andaj nga arsyet e mësipërme, kjo gjykatë vlerëson se në rastin konkret nuk ka shkelje të dispozitave të procedurës penale, sepse si gjykata e shkallës së parë e po ashtu edhe ajo e shkallës së dytë kanë bërë vlerësimin dhe arsyetimin e duhur, dhe në bazë të vlerësimit të tillë, kanë nxjerrë aktvendimet duke dhënë edhe arsyet të mjaftueshme, të cilat si të drejta i pranon edhe kjo Gjykatë, ndërsa mbrojtja në liri, sipas propozimit të mbrojtësit të të pandehurit nuk është masë adekuate për fazën në të cilën ndodhet procedura penale.

Nga sa u parashtrua më lartë dhe në kuptim të nenit 437 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.188/2024, me datë 25.3.2024.

Bashkëpunëtorja profesionale,
Qefsere Berisha

Kryetari i kolegjit,
Rasim Rasimi